



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.09.2024, nxjerrë këtë:

Dep.	DPKI	Nr. Prot.	1209/24
Dsp.		Br. Prot.	
Dep.		Prot. No.	
Nr. Fq.	03	Data	11.09.2024
Br. Str.		Datum	
Nr. Page		Date	
PRISHTINE			

V E N D I M

Mbyllet rasti DPKI-06-718/24, për zyrtaren znj. Nazlie Bala, Këshilltare Politike në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për znj. Nazlie BALA, Këshilltare Politike në Ministrinë e Drejtësisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet vijuese për konflikt të interesit të znj. Nazlie Bala, se:

"[...]Një këshilltare politike e një ministri/je para shumë viteve ka themeluar një OJQ që ka të bëjë me shërbime sociale. Emri saj si themeluese shihet edhe në listën e OJQ-ve në Ministrinë e Administratës. Pra Pozita e saj aty figuron vetëm si themeluese, ndërsa motra e saj është koordinatore.

- 1. A është konflikt interesi, nëse ajo OJQ merr mbështetjen financiare nga ministri ku punon këshilltarja. Pra, a ka konflikt nëse OJQ-ja e themeluar nga këshilltarja, para se të jetë këshilltare, merr fonde në thirrjet publike nga ministria ku punon ajo tash?*
- 2. A është konflikt interesi të përfitojë fonde publike OJQ-ja ku është koordinator i OJQ-së motra e këshilltares në atë ministri? "*

Pas kësaj Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka komunikuar përmes telefonit me raportuesin e rastit në fjalë për të sqaruar/konkretizuar me shume se për cilën OJQ dhe këshilltar/e bëhet fjalë, në mënyrë që APK të filloj me mbledhjen e dokumentacionit për të trajtuar në mënyrë të gjithanshme informatën e pranuar.

Pas sqarimeve të duhura përmes telefonit si dhe email-it zyrtar të pranuar nga raportuesi i rastit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me shkresën zyrtare APK-DPKI-06-953/24, e ka njoftuar zyrtaren znj. Nazlie Bala lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe më pas ka organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e

Agjencisë, me ç'rast e njëjta është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me këtë rast.

Në takim, znj. Nazlie Bala ka deklaruar se që nga themelimi i OJQ "Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve- Liria", asnjëherë nuk ka qenë në asnjë pozitë ekzekutive, menaxheriale e as në organe drejtuese të OJQ-së në fjalë. Gjithashtu, e njëjta ka deklaruar se nga janari i vitit të kaluar subvencionimi i shërbimeve sociale që ka qenë në Ministrinë e Financave, kanë kaluar tek Ministria e Drejtësisë, pra të gjitha strehimoret të cilat janë të regjistruara në nivel vendi aktualisht subvencionohen nga Ministria e Drejtësisë.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas takimit të mbajtur me znj. Bala, i ka kërkuar edhe me shkrim informacionin/dokumentacionin si në vijim :

"Çfarë funksioni keni aktualisht dhe keni mbajtur në OJQ "Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve- Liria, Gjilan", përkatësisht, nëse jeni (keni qenë) anëtare e ndonjë organi Drejtues në OJQ-në në fjalë ?"

Në përgjigje të kërkesës sonë, znj. Bala edhe me shkrim ka konfirmuar se lidhur me OJQ "Liria" Gjilan, deklaroj publikisht që, *'nuk kam pas dhe nuk kam asnjë funksion ekzekutiv apo menaxheriale e as anëtare e ndonjë organi drejtues. Për këtë deklaram timin, po e bashkëngjisë edhe dëshminë deklaruese nga OJQ-ja në fjalë'.*

Pas vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, si dhe informacioneve të siguruar nga Departamenti OJQ-ve, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstaton se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në nenin 14 [Anëtarësia në organizata joqeveritare], ka përcaktuar se:

- 1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.*
- 2. Organizata joqeveritare sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë.*


Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin të cilat i ka pasur në dispozicion Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, OJQ "LIRIA", sikurse edhe OJQ-të tjera të ngjashme subvencionohen nga Ministria e Drejtësisë, duke përjashtuar çfarëdo vendimmarrje nga znj. Bala në cilësinë e Këshilltares Politike në këtë Ministri, shtoj faktin se e njëjta nuk është (ishte) anëtare e ndonjë organi drejtues të OJQ-së në fjalë (përveç se njëra nga themelueset e OJQ-se së sipërpërmendur¹), prandaj, kjo situatë nuk përbën konflikt të interesit në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

¹ Informate e verifikuar nga departamenti i OJQ-ve.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

